



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

N J O F T I M

**PËR KANDIDATËT APLIKANTË PËR PJESËMARRJE NË PROVIMIN E
SHTETIT NË PROFESIONET E RREGULLUARA NË FUSHËN E MJEKËSISË
SEZONI XXVI**

Për të gjithë kandidatët aplikantë për pjesëmarrje në provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të **Mjekut, Farmacistit, Infermierit, Mamisë, Fizioterapistit, Logopedistit, Teknikut të Imazherisë** dhe **Teknikut të Laboratorit**, ju bëjmë me dije se aplikimi do të kryhet online përgjatë periudhës **16 – 23 Dhjetor 2024**, duke përdorur shërbimin “Aplikim për provim shteti” në platformën e-Albania.

Gjatë aplikimit online, kandidati duhet të ngarkojë dokumentet e mëposhtme:

- 1. Diplomën/diplomat e programit të studimeve për profesionin respektiv;*
- 2. Dëshminë e pjesëmarrjes dhe përfundimit me sukses të praktikës profesionale të lëshuar nga UP-ja ose në mungesë të UP-së, nga institucioni kompetent për kryerjen e praktikës, ku përcaktohet edhe kohëzgjatja;*
** Në raste të caktuara: Vërtetimin për njohjen dhe njësimin e diplomës në rast se studimet janë përfunduar jashtë shtetit; Dokumentacion të lëshuar nga institucioni përgjegjës për arkivat që provon lëshimin e diplomës apo dokumentit të barasvlershëm me të, të fituar nga institucioni i arsimit të lartë të mbyllur. Dokumenti që vërteton e vlefshmërinë e diplomës/diplomave të lëshuara.*
- 3. Vetëm pas njoftimit të pranimit nga Urdhri Profesional, faturën e pagesës së kryer për llogari të QSHA-së, e cila duhet të ngarkohet në sistem në fushën që shfaqet pas vendosjes së kodit të gjurmimit dhe kodit të sigurisë, brenda 72 orëve nga njoftimi i pranimit nga Urdhri Profesional.**

Kandidatët do të njoftohen në çdo fazë lidhur me statusin e aplikimit nëpërmjet postës elektronike, si dhe portalit e-Albania në rubrikën Hapësira ime – Mesazhet e mia.

Pas ngarkimit në sistem të pagesës, lutemi që kandidatët të qëndrojnë në pritje të email-it të pranimit nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.

Lidhur me aplikimin e shtetasve të huaj, pasi të zgjidhet shërbimi “Aplikim për provim shteti” në platformën e-Albania dhe opsioni “shtetas i huaj”, të plotësohen me kujdes fushat e kërkuara.

Kalendari i zhvillimit të sezonit dhe orari i pjesëmarrjes në provim për çdo kandidat, do të publikohen në vijim në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore www.qsha.gov.al.

***Për çdo problematikë lidhur me aplikimin, lutemi që kandidatët t’i drejtohen Urdhrave Profesionalë.**

Ju urojmë Suksese!